



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Cn.nr.287/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Zenel Leku dhe Nenad Laziq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B. H., nga F., të cilin e përfaqëson avokati Admir Salihu nga F., kundër të paditurës Kompania Kosovare për Furnizim me E. E. SH.A. (KESCO), me seli në P., të cilën e përfaqëson me autorizim T. K., lidhur me kompensimin e dëmit, duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lëndore midis Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, në Prishtinë, në seancën e kolegjit të mbajtur me 15.10.2024, mori këtë,

### A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike me kompetencë lëndore është Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, të cilës, shkresat e lëndës i dërgohen në procedurë të mëtejshme.

### A r s y e t i m i

Më datën 21.11.2016, pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, është paraqitur padia e paditësit Lokalit “M.”, në F., kundër të paditurës së lartë cekur, ndërsa, me parashtrësën e datës 4.04.2019, pala paditëse, ka bërë precizimin e padisë, ashtu që paditës është shtuar edhe personi fizik B. H., me kërkesë për kompensimin e dëmit si në precizimin e saj. Më datën 22.03.2022, Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin e nxjerrë në seancë ka aprovuar propozimin e të autorizuarit të paditësit dhe e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit Lokalit ” M. ” , F., ndërsa, si paditës tani e tutje ka mbetur vetëm personi fizik B. H.

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e saj C.nr.2021:167776 dt.15.12.2022, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas padisë së palës paditëse, dhe lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, duke vlerësuar se e njëjta ka juridiksion për të vendosur në çështjen konkrete.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KE.nr.381/23 dt.5.09.2024, lidhur me këtë çështje, ka hapur konfliktin e kompetencës midis Gjykatës Themelore në Ferizaj,

Departamenti i Përgjithshëm dhe Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, në Prishtinë.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme, të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës bazuar në dispozitën e nenit 25.2 të LPK-së dhe nenin 13.7 të Ligjit Për Gjykatën Komerciale.

Në vështrim të dispozitave të nenit 13, par.1, pika 1.1, pika 1.7 të Ligjit Për Gjykatën Komerciale, parashihet, veç tjerash parashihet se, Gjykata Komerciale ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë, në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridik publik dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështjet tjera mes tyre, përkatësisht, kontestet mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është e paraparë me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës dhe duke vendosur përkitazi me konfliktin e kompetencës lëndore midis Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë në Prishtinë, në mbështetje të dispozitave të sipër përmendura, si dhe të dispozitave të nenit 12.1 dhe 20 të Ligjit për Gjykatat, nenit 47 të LPK-së, ka gjetur se kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridiko-civile, është Gjykata Themelore në Ferizaj, përveç, tjerash, edhe për faktin se në rastin konkret civil juridik, midis ndërgjyqësve të lartë cekur, nuk kemi të bëjmë me raport afarist a çështje të ndërsjellë tregtare, por, me çështje kontestuese që ka të bëjë me kompensimin e dëmit, midis paditësit B. H. nga F., si person fizik, dhe të paditurës Kompania Kosovare për Furnizim me E. E. SH.A. “ KESCO ” , përkatësisht, me të dhënat si në padinë e paditësit dhe si në shkresat tjera të lëndës.

Ndaj, nga këtu dhe në mbështetje të dispozitës së nenit 25.2 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Cn.nr.287/2024.dt.15.10.2024

Kryetari kolegjit

Mr.Sc.Muhamet Rexha

